

VENDIM
Nr. 97, datë 20.5.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1054/1 prot., datë 16.5.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1054 prot., datë 8.5.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri ka një licencë të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, deri më 24.9.2024. Duke qenë se shoqëria nuk aplikoi brenda datës 24.3.2024 për rinovimin e licencës, referuar kjo nenit 16, pika 1, të rregullores, ku përcaktohet se: paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Shoqëria ka bërë aplikim të ri dhe afatet e licencës në rast miratimi do të fillojnë nga data 25.9.2024.

- Shoqëria e kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, e cila do të rakordohet në vijim me *statement-in* përkatës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat: “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “a”; si dhe pikën 2.4, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

Neni 9. Format i dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për shoqërinë dhe administratorin e saj;

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacion vërtetues për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj;

- germa “c”: aplikuesi duhet të përcjellë në ERE planin e biznesit dedikuar veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, për të gjithë periudhën e licencimit, e gjithashtu ky plan biznesi nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në kontratat e bëra me dije por të jetë në formën e kërkuar, i cili duhet të përmbajë përcaktime, në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e projektit/ushtimit të veprimtarisë për të cilën po kërkon të licencohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti